

Prof. Dr. Skender TOPI takim në Senatin e Republikës Italiane

Marrëveshje e rëndësishme midis Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Ekonomike për Fondet Evropiane

Më datë 6 Prill 2023 në Senatin e Republikës në Itali, u mbajt Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Fondet Evropiane, ku morën pjesë aktorë shkencorë nga Amerika e Veriut dhe aktorë shkencorë nga Zona Euromesdhetare.

Në këtë takim të rëndësishëm, Rektori i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Prof.dr. Skender Topi, nënshkroi marrëveshjen strategjike të bashkëpunimit me Presidentin e Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Ekonomike për Fondet e BE-së EU, Prof. Santi Tomaselli, me Prof. Michele Vincenti i Universitetit Perëndimor të Kanadasë, si dhe Përfaqësuesin e Punëve të Jashtme dhe Biznesit të Egjiptit Prof. Basem Ibrahim.

Në fjalën e tij përshëndetëse Prof. Skender Topi u shpreh:

“Jam i kënaqur, sepse kjo marrëveshje e nënshkruar në një nga godinat më të rëndësishme të institucioneve italiane si Senati i Republikës, shënon një arritje për Universitetin e Elbasanit në fushën e bashkëpunimit shkencor të Fondeve Evropiane.





